



Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1034, datë 16.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR RIFORCIMIN
E PALLATIT TË KULTURËS “DEDË NDUË LAZRI”, BASHKIA
LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për rihorcimin e pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Bashkia Lezhë.
2. Përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësia zbatuese Bashkia Lezhë, në masën 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë, për financimin e rihorcimin e pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Bashkia Lezhë.
3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rihorcimit të pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Bashkia Lezhë, të jetë në masën 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë dhe të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.
4. Fondi për financimin e rihorcimit të pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri” i transferohet njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE


MINISTRI I SHËTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6350/1
DATË 17.12. 2020

MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË LEZHË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

